



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË
V E N D I M

Nr. 61 dt.28.06.1995

MBI DHENIEN E NDIHMES EKONOMIKE DHE PERFITIMIN E
PAAFTESISE PER MUAJIN MARS 1995

Në zbatim të ligjit Nr.7710, dt.18.05.1993 “Për ndihmën dhe përkujdesjen shoqërore”, ligjit Nr.7886, dt.08.12.1994 “Për disa ndryshime”, në ligjin Nr.7710, dt.18.05.1993, VKM Nr.453, dt.26.09.1994 “Për dhënie e ndihmës ekonomike”, VKM Nr.311, dt.11.07.1994 “Për përfitimin e paaftesisë”, Këshilli Bashkiak i mbledhur sot me dt.28.06.1995, pasi shqyrtoi relacionin e Seksionit të Përkrahjes Sociale

VENDOSI

- 1.** Për muajin mars 1995 të përfitojnë ndihmë ekonomike gjithsej **12.337 familje** me një fond prej **29 milion lekë**.
- 2.** Të përfitojnë këto familje **7 milion lekë** për kompesimin e energjisë elektrike.
- 3.** Të përfitojnë ndihmë ekonomike të plotë si raste të veçanta :
 - Luljeta Mali, familje me 1 antarë, Nj.A.Nr.3
 - Elida Kukeli, familje me 1 antarë, Nj.A.Nr.5

- Sofone Lagji, familje me 1 antarë, Nj.A. Nr.6
- 4. Të përfitojnë ndihmë ekonomike për përkujdesje Mirela Taku, Nj.A.Nr.10.
- 5. Të përfitojnë ndihmë ekonomike duke u afruar në nivelin maksimal **Shefqet Taku**/gjithsej 3738/, Nj.A.Nr. 10, familje me 3 antarë.
- 6. Të rifuten në skemën e ndihmës ekonomike Ibrahim Jonuzi, familje me 5 antarë dhe Fatmir Bleta, familje me 4 antarë, Nj.A.Nr.5.
- 7. Tu ndërpritet ndihme ekonomike **75 familjeve** sipas pasqyrave të bashkangjitura në relacion.
- 8. Të miratohet kërkesa për bllok ndihmë për tremujorin e dytë të 1995.
- 9. Të përcaktohet masa e ndihmës ekonomike për çdo familje për muajin prill 1995.
- 10. Të përfitojnë ndihmë ekonomike **989 persona** të paaftë me një fond prej **1.5 milion lekë**.

KRYETARI

BESNIK PETRELA